



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:099246

Datë: 21.01.2021

C.nr.1125/17

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i përgjithshëm- Divizioni civil, me gjyqtaren Ganimete Puka, sipas padisë se paditëses:me seli në, të cilën e përfaqëson sh.p.k me seli në Prishtinë, rr. “.....” nr.29, kundër të paditurve: 1.) V. D., 2.) N. D. nga, rr. “.....” nr. 2, 3.) E. D. nga, rr. “.....” nr. 10, të përfaqësuar nga av. Mustafë Kastrati nga, sipas autorizimit, për: kthim të kredisë, vlera e kontesti 7.306.71 €, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur në prezencë të autorizuarit të paditëses Mirjeta Krasniqi, e në mungesë të paditurve dhe të autorizuarit të tyre av. Mustafë Kastrati, me datë 11.01.2021 , gjykata me datë 21.01.2021, bie ketë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET në tersi kërkesëpadia e paditësesme seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga sh.p.k (.....)me seli në, rr. “.....” nr.29, me të cilën ka kërkuar që të **DETYROHEN** të paditurit V. D., nga, rr. “.....” nr. 10, E. D. nga, rr. “.....” nr. 10, dhe N. D. nga, rr. “.....” nr. 2, në, që solidarisht , paditëse t’ia paguaj në emër të borxhit bazë 6500€, me kamate e interesit, në shumën e përgjithshëm prej 7.306.71 €, me kamatë vjetore prej 8% e cila do të llogaritet nga data ushtrimit të padis 24.10.2017, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit, si e pa bazuar.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Përfaqësuesja e autorizuar e paditësit , në padinë e datë 24.10.2017, të precizuar me parashtrësën e datës 15.11.2019, gjatë shqyrtimit kryesor dhe fjalës përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë fjalës përfundimtar të dorëzuar me shkrim, duke theksuar se me të gjitha provat e parashtruara e të administruara nga gjykata , vërtetohet në tersi kërkesëpadia e paditësit , dhe se kërkesa e paditësi është ushtrua brenda afatit ligjor, dhe pretendim i të autorizuarit të paditurës se kërkesa e paditësit është parashkruar nuk qëndron . Pra e paditura V. D. , si kredi marrëse dhe i padituri E. D. , si bashkë kredi marrës, kanë nënshkruara kontratë për kreditë në shumë prej 6500€, me kusht të përmbushjes se kontratës për 36 muaj, ndërsa i padituri N. D., si garantuese . Paditësi, sipas kësaj marrëveshjes të kredisë, me datë 01.03.2009, në xhirollogarinë të paditurës V. D. , ka transferuar shumën e kredisë prej 6.500 €, që vërtetohet nga Pasqyra e Qarkullimit në Llogari e datës 01.03.2009, pra të paditurit me vullnetin tyre kanë hy në raporte kontraktuese me paditësi dhe bazuar në ketë , të paditurit të detyron që paditësit në mënyrë solidarë t ia paguajnë borxhin paditësit në shumë prej 6.500, me kamat të interesit , në tersi shumën prej 7306.71€, si dhe shpenzimet e procedurës.

E paditura V. D., në përgjigje në padi, të datës 29.12.2017, të dorëzuar në gjykatë me datë 03.01.2018, e ka kontestuar në tersi kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetim se ka nënshkruar kontratë me, e jo me ndërmarrjen për mbledhjen e borxheve të këqija dhe me DRLL, nuk ka nënshkruar kontratë mbi kredinë, dhe kreditori e ka inkasuar borxhin e saj.

I autorizuari i të paditurve Musafë Kastrati avokatë në Pejë, në seancën e shqyrtimit përgatitor të mbajtur me datë 13.02.2020, si dhe gjatë shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 24.06.2020, dhe të dt. 14.09.2020, e ka kontestuar në tersi kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetim se kërkesëpadia e paditësit është e parashkruar, pasi që kredia është aprovuar me dt. 10.03.2009, dhe padia është paraqitur me dt. 24.10.2017, dhe ka kaluar afati për realizimin e kërkesës nga paditësi, si dhe kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, për faktin se të paditurit nuk kanë lidhur marrëveshje me paditësin DRLL, dhe në marrëveshjen e kredisë figuron logondërsa në kontratë është vula e DRLL, kjo kompani në vitin 2009 nuk ka ekzistuar, sepse është regjistruar si kompani në vitin 2014, dhe nënshkrimi i të paditurës V. D. nuk është i saj, ndërsa të paditurit E. dhe N. nuk janë nënshkrues të marrëveshjes së kredisë, si dhe paditësi, e ka inkasuar borxhin saj, përmes përbaruesi privat, me shenje P.nr.46/15, për çka edhe ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata në kuptim të dispozitave të nenit 423.4 të LPK/së, seancën e shqyrtimit kryesor të datës 11.01.2021, e ka mbajtur në mungesë të autorizuarit të paditurve, pas që gjykata ka konstatuar se i autorizuari i të paditurve ka që i ftuar në mënyrë të rregull, që vërtetohet sipas flet kthesës e datës 30.11.2020, i njëjti thirrjes se gjykatë nuk ju ka përgjigj dhe mos prezencë nuk e ka arsyetuar.

Gjykata në këtë çështje juridike - kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palës paditëse ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat: Kontrata e kredisë, nr.09 dt. 10.03.2009, dy marrëveshja mbi pengun /09, dt. 10.03.2009, autorizimi për përfaqësim DRL –së nga, vërtetimi për garantuesin E. D., qarkullimi i llogaris për të paditurën V. D. e dt.10.09.2020, ka refuzuar propozimin për sigurimin e shkresave të lëndës P.nr46/15, të përbaruesi privat Fatos Shatri, si dhe ka revokuar aktvendimi e datë 24.06.2020, për dëgjimin e të paditurës V. D., si dhe deklaratimet e të autorizuar të palëve ndërgjyqësore.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku e në lidhmëni njëra me tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurë Kontestimore, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike - civile duhet vendosur si në dispozitiv, të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nga provat e administruara është jo kontestues fakti se e paditura V. D. ka lidhur marrëveshje mbi kredinë, me paditësinme seli në, me numër nr.09, dt. 10.03.2009, nga e cila e paditura ka marr kredi shumë prej 6500€, me afat të kthimit 36 muaj, me kamat vjetor 12% në vite. Po ashtu palët kontraktuese kanë kontraktuar edhe kamatë ndëshkuese në rast të mos kthimit të anuiteteve sipas afat të caktuar në shkallën prej 0.5% në çdo ditë vonese.

Nga marrëveshja mbi pengun e datë 10.03.2009, gjykata vërteton se e paditura V. D., garanton për sigurimin e kredisë së akorduar sipas kontratës nr.9, përmes lënje peng të sendit të luajtshëm, veturës, në vlerë prej 3000€.

Nga marrëveshja mbi pengun e pa datuar, Gjykata konstaton se e paditura V. D., ka lenë peng , veturën2001,, në vlerë prej 8.000 € (nuk dihet se për çfarë shumë të borxhit është lenë pengë shitjen e veturës).

Nga vërtetimi i lëshuar nga, (pa datë), garantuesi/ i padituri E. D., ka garantuar me pagën mujore prej 550€, sipas kontratë së punës firmës VF,,, prej datë 2005, e tutje.(nuk dihet së për çfarë shumë të kredisë-borxhit është garantuar)

Në pasqyrën e qarkullimit të llogaris , të lëshuar nga paditësi, me datë 10.09.2020, Gjykata vërteton faktin se në xhirollogarinë e të paditurës V. D. , me dt. 11.03.2009 , i lëshohet kredia në shumë prej 6.500 €, ndërsa e paditura V. D., të nesërmen me dt. 12.03.2009, e tërheqë kredinë në shumën prej 6.460 €, dhe e paditura V. D., fillon me pages e kësteve mujore , duke filluar pagimin e kredisë me dt. 16.04.2009 , shumën 216 €, dt.18.05.2009 shumën 210€, dt. 01.07.2009 shumën prej 210€, dt, 07.08.2009 shumën 225 €, dt. 31.08.2009 shumën 217 €, dt.23.09.2009 shumën 225 €, 15.10.2009 shumën 216 €, datë 19.11.2009 shumën 218 €, dt. 28.12.2009 shumën 218 €, pra për 9 muaj të vitit 2009, është paguar 1.962 €, për vitin 2010 , janë paguar 10 muaj , nga 218 €, në totale 2.180 €, si dhe për vitin 2011 , është paguar vetëm për një muaj në shumë prej 218 €, **dhe totali i paguar është shuma prej 4360€.**

Gjatë shqyrtimit kryesore nuk ka qenë kontestuese fakti se paditësi, me të paditurën V. D., kanë krijuar raporte kontraktuese për kredi në shumen prej 6500€, me datë 10.03.2009, sipas marrëveshjes/ kontratës për kredi nr.09, dt.10.03.2009.

Kontestuese në mes palëve është ngrit çështja se kërkesëpadia e paditësit është apo nuk është e parashkruar, dhe përfaqësuesi i paditësit , pretendon se padia është ushtruar brenda afatit ligjor, ndërsa i autorizuari i të paditurve mendon se borxhi në emër të kredisë , kthimi i të cili po kërkohet është i vitit 2009, dhe padia e ushtrua në gjykatë me 2017 , si dhe paditësi ka inkasuar borxhin në emër të kredisë.

Vlerësimi ligjor i kërkesëpadisë.

Me nenin 17 të LMD-së është përcaktuar se pjesëmarrësit në marrëdhënie të detyrimit kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij. Ndërsa, sipas nenit 1065 të LMD-së, me kontratën e kredisë, banka detyrohet që shfrytëzuesit të kredisë t'i vë në dispozicion shumën e kontraktuar të mjeteve në të holla, në kohë të caktuar ose të pacaktuar, për ndonjë destinim të caktuar ose pa caktim destinimi, ndërsa shfrytëzuesi i kredisë detyrohet që bankës t'ia paguaj kamatën e kontraktuar dhe shumën e marrë të të hollave t'ia kthej në kohën dhe mënyrën e përcaktuar me kontratë.

Gjykata ka vendos që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit, pas që në rastin konkret, u vërtetua se paditësi, me të paditurën V. D., kanë nënshkruar marrëveshje për kredi për shumën e kredisë prej 6500€, me afat kthimi për 36 muaj, që vërtetohet me kontratën e kredisë nr.09, e datë 10.03.2009, e cila shumë me datë 11.03.2009, bartët në xhirollogarinë e të paditurës , e paditura menjëherë me dt. 12.03.2009, e tërheqë kredinë në shumën prej 6.460 €, dhe fillon me pagesën e kësteve mujore duke paguar për nëntë muaj (9) muaj të vitit 2009, shumën prej 1.962.00 €, për vitin 2010 , kishte paguar shumën prej 2.180.00 €, si dhe për vitin 2011 , shumë prej 218 €, **dhe totali kishte paguar shumën prej 4360€, që vërtetohet nga pasqyra e llogaris së bankës dt.10.09.2020.**

Ndërsa nga marrëveshja mbi pengun, e datës 10.03.2009, rezulton se e paditura V. D., si garantuese kishte lënë pengë automjetin e saj , në vlere prej 3000€, pra për sigurimin e kredisë , sipas kontratës në fjalë nr.9, në një situatë të tillë të vërtetuar , gjykata konsideron se e paditura V. D., ka kryer obligimin kontraktuese ndaj paditësit , pra në mënyrë të qartë u vërtetuar se e paditura ka paguar një pjesë të kredisë në lartësi prej 4360 € , përmes bankës përfshirë interesin , dhe 3000€, me marrjen e automjetit të lënë pengë, në totalë shumën 7360€.

Pra gjykata ketë përfundim e ka nxjerr, pasi që ka vërtetuar se paditësja ka siguruar kredinë sipas kontratë nr.9, të datë 10.03.2009, ky e paditura V. D., kishte garantuar duke lënë pengën veturën e saj,,(marrëveshja e pengu dt.10.03.2009) dhe kjo u vërtetuar edhe nga pohimet e përfaqësueses së paditësit, e cila gjatë shqyrtimit të kësaj çështje me konkretisht në seancën e mbajtur me datë 13.02.2020, e cila ka pohuar se për ketë borxhe me marrëveshje mbi pengun është marr vetura , për çka edhe u vendos sikur në dispozitive të këtij aktgjykimit.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontesti morë e bazoj në dispozita ligjor të nenit 450 të LPK-së, që secila palë ti barte shpenzimet e veta procedurale.

Nga arsyet e lartcekura , në kuptim të dispozitave ligjor nga nenin 143 të LPK/së, u vendos sikur në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:099246, 21.01.2021

G j y q t a r e

Ganimete Puka

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15, ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2019:099246
Datë: 21.01.2021
Numri i dokumentit: 01430454